



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02.nr. 4291 /2021

Duke u bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega Kaçanik C.nr.46/2021 i datës 31.05.2021, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit nxjerrë:

V E N D I M
PËR PAGESËN E SHUJTAVE TË PUNËTORËVE TË ARSIMIT PËR VITIN 2017

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e shujtave të punëtorëve të arsimit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2017, sipas **Aktgjykimit të C.nr.46/2021**.
2. Shuma e mjeteve të përgjithshme për pagesën e shujtave ditore për vitin 2017 është **37,680.64 € (Tridhjetë e shtatmijë e gjashtëqind e tetëdhjetë euro e gjashtë e katër cent)** dhe taksa gjyqësore në shumë prej **150 €, (Njëqind e pesëdhjetë euro)**.
3. Sipas Aktgjykimit palët janë dakorduar që pjesa e shujtave për vitin 2017 të kryhet gjatë muajit Qershor 2021, ndërsa mjetet do të merren nga kategoria Mallra dhe Shërbime nga drejtoritë komunale dhe të derdhen në llogarinë e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me numër **130 200 120000 4545 në bankën BpB**.
4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financave që të bëjë procedimin e vendimit për pagesën e shujtave ditore për vitin 2017 në zbatim të këtij vendimi, sipas listave të përgaditura nga shkollat, listat e drejtorisë së financave dhe sipas Aktgjykimit C.nr.49/2021, të cilat do të jenë pjesë e këtij vendimi.
5. Me këtë vendim njoftohen: Sindikata Komunale e Arsimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Data: 15.06.2021
Hani i Elezit

